



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "N.T.SH. EUROPA - BASTRI ADEMI B.I." të datës 05.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 01.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-2421-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 063 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "N.T.SH. EUROPA - BASTRI ADEMI B.I." e datës 05.06.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 01.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-2421-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 063 211 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 01.06.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në rivlerësim aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "N.T.SH. EUROPA - BASTRI ADEMI B.I." si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "N.T.SH. EUROPA - BASTRI ADEMI B.I." (tutje "parashtruesi") me datë 05.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 01.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-2421-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 063 211. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit.

Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

**Pretendimi i parë (I)** – “Në momentin kur AK-ja ka rekomanduar për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik SFISHTA AUTO HOME SH.P.K.; N.T.SH. BESI është shkel neni 1 pasi që ky grupi OE nuk ka çmime reale të tregut dhe realisht fondet publike me këtë OE nuk do të shfrytëzohen në mënyren me efikase dhe transparente pasi ka çmime manipulative dhe të cilat fare nuk korespondojnë me çmimet e tregut. Në vijim i keni disa çmime të grupit të OE të rekomanduar për kontratë e që realisht është dasht konform neni 61 të LPP-së të eliminohet për çmime abnormalisht të ulëta”.

**Pretendimi i dytë (II)** – “Autoriteti Kontraktues vlersojm që ka shkelur nenin 28 të LPP-së pasi që në kuader të specifikimeve apo listes së çmimeve ka inkorporuar edhe Gomat e Veres dhe Gomat e Dimrit për veturat në fjalë që AQP-ja për këto lloje të veturave ka kontratë aktive me një operator ekonomik për furnizim me goma. Vlersojm që AK në këtë rast e ka shpërfill AQP-në duke i vendosur këto specifika te lista e çmimeve”.

**Pretendimi i tretë (III)** – “Autoriteti Kontraktues konsiderojm që ka shkelur nenin 28 të LPP-së specifikimet teknike pasi që në çdo listë të çmimeve ka vendos peshimin prej 60% që do të thot për tu peshuar në total çmimet duhet 240% peshini”.

**Pretendimi i katërt (IV)** – “OE i cili është renditur i dyti ORIOVISION është i pa përgjegjshëm pasi që nuk e ka QERTIFIKATEN ISO 9001:2015”.

**Pretendimi i pestë (V)** – “OE i renditur i treti GANI KRASNIQI B.I. te lista e çmimeve ka ofertuar për pozicione të njëjta me çmime të ndryshme”.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 28, 59 dhe 61 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 07.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

**Lidhur me pretendimin e parë (I)** – fillimisht duhet cekur se përmes neni 61 paragrafit të LPP përcaktohet se “Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim: (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni”. Tutje, përmes neni 41 paragrafit 41.1 të RRPP përcaktohet se “Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të parë duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës”.

Sipas nenit 41 paragrafit 41.6 të RRPP, "në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zberthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP - Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët". Përmes nenit 41 paragrafit 41.3 të RRPP përcaktohet se "Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përnubushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë".

Duke marrë parasysh dispozitat e cituara si më sipër (neni 61 par. 1 i LPP dhe neni 41 par. 41.1, 41.3 dhe 41.6 të RRPP), janë administruar si prova procesverbali i hapjes, raporti i vlerësimit dhe njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues. Me këtë rast është gjetur se në këtë aktivitet të prokurimit kanë janë dorëzuar pesë (5) oferta me çmimet si në vijim:

1. GOE "Sfishta auto home" - 24,732.79 Euro & "N.T.Sh. Besi"
2. OE "Oriovision" Sh.P.K. - 35,854.57 Euro
3. OE "Gani B. Krasniqi" B.I - 90,817.64 Euro
4. OE "Bastri Ademi" B.I. - 95,252.36 Euro
5. OE "Mirsad Gashi" B.I. - 103,315.99 Euro

Në kuptim të nenit 41 paragrafit 41.3 të RRPP është gjetur se mesatarja e ofertave të tenderuesve në rastin konkret është 69,994.67 Euro. Nëse kësaj shume i zbresim 30% atëherë rezultati është 48,996.27 Euro. Kjo nënkupton se shuma me të cilën ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është dukshëm më shumë se 30% më e ultë se çmimi mesatar i tenderëve të ofertuar. Në anën tjetër çmimi i ofertuar nga tenderuesi e rekomanduar është 31.02% më i ultë se tenderi i dytë me radhë (që nënkupton se ky tender është dukshëm më shumë se se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët). Në këtë mënyrë është gjetur se janë plotësuar të gjitha kushtet të përcaktuara me nenin 61 të LPP dhe 41 të RRPP sipas të cilave komisioni vlerësues është dashur që të kërkoj sqarime nga tenderuesi në fjalë sipas shkresës standarde për tenderët jonormalisht të ulët. Megjithatë komisioni vlerësues nuk ka vepruar në mënyrë të tillë dhe kësisoj ka bërë një shkelje esenciale absolute të dispozitave procedurale të RRPP dhe LPP. Duhet theksuar se sqarimi i tenderëve që mund të jenë jo-normalisht të ultë është e domosdoshme, aq më shumë për aktivitetet e prokurimit ku aplikohet çmimi për njësi sikurse që është rasti në fjalë. Pa çka se evitimi i këtyre situatave është i domosdoshëm sikurse është përcaktuar me RRPP dhe LPP, sqarimi që komisioni vlerësues detyrohet të kërkoj nga tenderuesi në këto situata nuk duhet të paragjykohet me rastin e vlerësimit të tenderëve. Sidoqoftë, në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i dytë i parashtruesi është i bazuar pasi që komisioni vlerësues ka bërë shkelje të nenit 61 të LPP lidhur me nenin 41 të RRPP.

**Lidhur me pretendimin e dytë (II) dhe të tretë (III)** – duhet theksuar se të dy këto pretendime i referohen specifikave teknike respektivisht paramasës së dosjes së tenderit (tutje “DT”). Padyshim që parashtruesi ka pasur në dispozicion të gjitha mundësitë ligjore që të shfrytëzoj mjetet juridike lidhur me specifikat teknike të DT në fazën fillestare të aktivitetit të prokurimit. Mirëpo parashtruesi nuk ka shfrytëzuar asnjë nga këto mjete juridike gjatë asaj faze të procedurës. I njëjti ka dorëzuar ofertën e tij në përputhje të plotë pikërisht me këto specifika teknike respektivisht paramasë të DT. Në anën tjetër vetëm pas njoftimit mbi vendimin ku parashtruesi është renditur në vendin e katërt në mesin e pesë ofertuesve, parashtruesi tenton që përmes kërkesës për rishqyrtim të godasë specifikat teknike/paramasën e DT. Mirëpo në këtë fazë të procedurës nuk është e lejuar të ndryshohen specifikat/paramasa në formën dhe mënyrën sikurse pretendon parashtruesi sepse një veprim i tillë nuk mbështetet nga LPP dhe RRPP.

Sidoqoftë sa i përket pretendimit të dytë duhet sqaruar se ky aktivitet i prokurimit si i tillë nuk është në listën e AQP për procedurat e centralizuara të prokurimit. Me këtë rast duhet theksuar faktin se lista e AQP për procedurat e centralizuara është miratuar përmes vendimit të Qeverisë me nr. 07/140 të dt. 26.04.2023. Në anën tjetër ky aktivitet i prokurimit që edhe ashtu nuk është pjesë e kësaj liste (sipas destinimit dhe emërimit) është inicuar më 22.03.2023 përkatëse më shumë se një (1) muaj para se të miratohet lista e AQP. Kuptohet që vendimi i qeverisë si i tillë nuk ka manifestuar efekte retroaktive prandaj është vazhduar me procedurat e filluara para këtij vendimi. Rrjedhimisht me datë 01.06.2023 është publikuar edhe B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Nuk është kontestuese “si duhet të veprojnë autoritetet kontraktuese me aktivitetet të cilat janë inicuar (publikuar) para datës së hyrjes në fuqi të vendimit në fjalë” pasi që një çështje e tillë është konfirmuar edhe nga vet KRPP ku thuhet se ligjet respektivisht vendimet nuk mund të kenë fuqi retroaktive (shih te pyetjet e shpeshta për KRPP, pyetja nr. 35). Sidoqoftë, duhet pasur parasysh që as në listën e AQP në fuqi (të dt. 26.04.2023) nuk evidentohet “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të KPSH”. Prandaj pretendimi i dytë i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

**Lidhur me pretendimin e katërt (IV) dhe të pestë (V)** – fillimisht duhet cekur se këto pretendime të parashtruesit janë tërësisht jorelevante dhe kundërthënëse mes veti. Kjo për arsye se në këtë rast pretendimet e parashtruesit ndërlidhen me tenderuesit e renditur në vendin e dytë dhe të tretë (vet parashtruesi është renditur në vendin e katërt). Mirëpo në rastin konkret kriteri i dhënies së kontratës është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë që nënkupton se është jorelevante pjesa e pretendimeve që mund të ndërlidhen me tenderuesit që nuk janë të rekomanduar si tenderues të përgjegjshëm me çmimin më të lirë. Në rastin konkret parashtruesi nuk ka arritur që të sqaroj se me cilin veprim komisioni vlerësues ka mund të bëj shkelje të cilës dispozitë ligjore në fuqi. Në këtë kontekst pretendimet e parashtruesit janë edhe kundërthënëse mes vete. Këto pretendime janë të pa argumentuara dhe si të tilla të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij të parë. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim është konfirmuar se pretendimi i parë i parashtruesit është i bazuar. Kjo pasi që është gjetur se komisioni vlerësues ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 të LPP lidhur me nenin 41 të RRPP. Njëkohësisht është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij nr. 2, 3, 4 dhe 5. Po ashtu edhe nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit me nr. 2, 3, 4 dhe 5 janë tërësisht të pabazuara. Për këto arsye është miratuar vetëm si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesi dhe atë vetëm sa i përket pretendimit të tij të parë.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 07.06.2023**

**Visar SHEHU**  
  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Koruna e Prishtinës  


**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.